



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

STUDIMET POSTDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

“NDIKIMI I MENAXHIMIT TË KLASËS NË SJELLJET E NXËNËSVE”

Dr. Prof.

Arafat Shabani

Punoi:

Remzije Sadiku -Alidemaj

Tetovë, 2018



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

STUDIMET POSTDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

“NDIKIMI I MENAXHIMIT TË KLASËS NË SJELLJET E NXËNËSVE”

Dr. Prof.

Arafat Shabani

Punoi:

Remzije Sadiku -Alidemaj

Tetovë, 2018

DEKLARATË STATUORE

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se këtë punim e kam bërë unë dhe asnjëherë nuk është prezantuar para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Pra, punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

NDIKIMI I MENAXHIMIT TË KLASËS NË SJELLJET E NXËNËSVE

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “MASTER” Remzije Sadiku-Alidemaj
Udhëhequr nga: Prof. Dr. Arafat Shabani

Juria e mbrojtjes:

1. Prof. Dr. Arafat Shabani (Kryetar)
2. Prof. Dr. Hasan Jashari
3. Prof. Dr. Rashit Emini

Tetovë, 2018

ABSTRAKT

Ndikimi i menaxhimit të klasës në sjelljet e nxënësve ka qenë dhe mbetet një ndër shqetësimet më serioze të shkollës sonë. Ky studim eksploron se çfarë marrëdhëniesh ka midis nxënësve dhe mësimeve, bashkëpunimin në mes të mësimeve, bashkëpunimin me strukturat tjera udhëheqëse të shkollës. Më konkretisht sjelljet e nxënësve, të cilat ndikojnë gjatë menaxhimit të një ore mësimore, në klasë gjatë tërë vitit shkollor.

Menaxhimi i një klase gjithmonë ka qenë një shkencë më vete, e cila kërkon përkushtim të madh, një qasje precize, të qartë dhe, në veçanti, kur me të përcillen dhe analiza të sjelljeve të nxënësve. Shumë pedagogë, studiues, të ndryshëm potencojnë që puna e konsistuar, kontinuele si dhe praktika të vazhdueshme ndihmon në zgjidhjen më të shpejtë të faktorëve që ndikojnë gjatë menaxhimit të klasës në sjelljet e nxënësve.

Qysh në fillim duhet të njihemi me praktikate menaxhimit të sjelljeve të nxënësve në shkollë, me strategjitë e ndryshme për të trajtuar probleme të llojllojshme. Këto strategji mund të jenë analitike-metodike-didaktike të administrimit të klasës.

Në pikëpamje tjetër njohja e strategjive administruese për përcjelljen e sjelljes së nxënësve në shkollë, i krijon mundësi mësimeve të marrë masa parandaluese me kohë dhe për të gjitha këto dukuri negative që prezantohen.

Gjatë këtij hulumtimi qëllimi kryesor imi ka qenë të njihen faktorët që ndikojnë në menaxhimin e klasës, trajtimi i drejtë dhe adekuat që lidhet me sjelljen e nxënësve, këshilla dhe ndihma për t'i mësuar nxënësve se si të sillen në të ardhmen, të kuptuarit nga ana e nxënësve pse ata janë të kufizuar në aftësitë apo liritë që kanë për të bërë një zgjidhje të mirë të sjelljes së tyre në klasë dhe jashtë shkolle. Sepse shpesh gjatë zhvillimit të procesit edukativ-arsimor ndeshen edhe raste kur sjellja problematike e nxënësve është produkt i faktorëve të streseve objektive dhe subjektive.

Gjatë këtij studimi do të ketë edhe pyetësorë të nxënësve-mësimdhënësve të dyshkollave ShFMU “Eqrem Çabej” dhe “Bedri Gjinaj” që punojnë në qytetin e Mitrovicës, me gjithsej 40 nxënës prej moshës 12 -15 dhemësimdhënës. Po ashtu, në kapitullin e katërt do të ketë një analizë sociologjike që është bashkëpunim me mësimdhënës.

Fjalëkyçe: menaxhim, udhëheqje, nxënës, klasë, sjellje, arsim, mësimdhënës, integrim

АПСТРАКТ

Влијанието на управувањето со класите врз однесувањето на учениците е една од најсериозните проблеми. Оваа студија го истражува односот помеѓу учениците и наставниците, соработката меѓу наставниците, соработката со други структури за управување со училиштата. Поконкретно, ги истражува студентските однесувања кои влијаат врз управувањето со класата во училницата за време на учебната година.

- Управувањето со училницата отсекогаш била сама наука, што бара голема посветеност, прецизен и јасен пристап, проследена со анализа на однесувањето на учениците.
- Многу педагози и научници нагласуваат дека континуираната работа и практика помагаат во брз избор на фактори кои влијаат врз управувањето со училницата во однесувањето на учениците.
- Треба да се запознаеме со практиките на управување со однесувањето на учениците во училиштето и различни стратегии со цел да се третираат разни проблеми. Овие стратегии можат да бидат аналитички-методички-дидактички во администрацијата на училницата.
- Од друга перспектива, познавањето на административните стратегии за следење на однесувањето на учениците во училиштето создава можност за наставниците да преземат превентивни мерки навреме за било каква негативна појава што може да се појави.
- Во текот на ова истражување главната цел е да се идентификуваат фактите што влијаат врз управувањето со училницата, фер и адекватен третман на однесувањето, советите и помошта на учениците за да ги научат учениците како да се однесуваат во иднина, разбирање од ученикот за тоа зошто се ограничени во нивните способности и слобода да се направи добар избор во нивното однесување во училницата и надвор од училиштето, бидејќи многу често во текот на образовниот

процес има случаи кога проблематичното однесување на ученикот е производ на објективни и субјективни фактори.

- Оваа студија ќе вклучува прашалник на наставници и ученици од две училишта, "Екрем Кабеј" со вкупно 40 ученици, од 12 до 15 години и 20 наставници и од училиштето "Бебри Ѓинај" со вкупно 40 ученици и 10 наставници .
- Освен тоа, четвртото поглавје ќе содржи социолошка анализа за соработката со наставниците.

Клучни зборови: менаџмент, лидерство, студент, училница, однесување, образование, наставник, интеграција.

ABSTRACT

The impact of class management on the behavior of students is one of the biggest concerns and this study explores as to which are the relationships between students and teachers, cooperation between teachers, cooperation with other school management structures, more specifically, the behaviors of students that have an impact on the management of a teaching class during a school year.

Class management has always been a science in itself and it requires a great commitment, a precise and clear approach, followed in particular by the analysis of student behavior. Many pedagogues and scholars emphasize that the consistent and continuous work as well as continuous practice help in quickly identifying the facts that have an impact on the student behavior during the class management.

We should get familiar with the practices of management of student behavior in school and various strategies in order to tackle various problems. These strategies can be analytical-methodical-didactical in class administration.

From another perspective, the familiarity with administrating strategies for monitoring the student behavior in school creates an opportunity for the teachers to take preventive measures in time for all negative occurrences that may arise.

During this research the main purpose is get familiar with the factors that have an impact on the class management, right and adequate approach related to student behavior, advice and help in order to teach students how to behave in future, understanding from students as to why they are restricted in their abilities or their freedom in order to provide a good solution to their behavior in and out of the

class, because during the teaching often we encounter situations when the problematic behavior of the student is a product of the stress factors of objective and subjective nature.

During this study there will also be questionnaires of students-teachers of both schools, lower primary secondary school “Eqrem Cabej” with a total of 40 students, 12-15 years of age and 20 teachers of lower primary secondary school “Bedri Gjinaj” with a total of 40 students and 10 teachers.

In addition, in the fourth chapter there will be a sociological analysis in partnership with the teacher.

Key words: management, leadership, student, class, behavior, education, teacher, integration

MIRËNJOHJE

Falënderimi kryesor shkon për udhëheqësin shkencor, Prof. Dr. Arafat Shabani, i cili e ndoqi këtë disertacion hap pas hapi, duke mbështetur risitë që përcillte, por njëkohësisht me vërejtjet, sugjerimet e vlefshme synoi drejt ngritjes së nivelit shkencor të punimit.

Një falënderim i veçantë shkon për mësuesit e klasave, nxënësit ku u krye studimi, që mbështetën me gatishmërinë e tyre dhe përgatitjen serioze gjatë mësimdhënies.

Ky studim nuk do të mundësohej pa mbështetjen e jashtëzakonshme të familjes dhe bashkëshortit tim.

PASQYRA E LËNDËS

Deklaratë statutore.....	2
Abstrakti.....	3
Mirënjohje.....	9
Përmbajtja.....	10
Hyrje.....	11
Metodologjia e hulumtimit.....	13

PJESA E PARË

Kapitulli i parë

Si ta kuptojmë menaxhimin në klasë	14
Faktorët kryesor në sjelljet e nxënësve	17

Kapitulli i dytë

Menaxhimi i klasës sipas standardeve pedagogjike	24
--	----

PJESA E DYTË

Kapitulli i tretë

Rezultatet e pyetësorëve të mësimitdhënësve	32
Rezultatet e pyetësorëve të nxënësve.....	47

Kapitulli i katërt

Analizë sociologjike (në bashkëpunim me mësimitdhënësen e Ed.qytetare).....	63
Konkluzion.....	66
Rekomandimet.....	68
ANEKS	
Pyetësori për mësimitdhënës	71
Pyetësori për nxënës	77
Momente gjatë plotësimit të pyetësorit	83
Referencat.....	84

HYRJE

Në përgjithësi arsimit parauniversitar prej dy dekadash është në një proces ndryshimesh të thella komplekse, pjesë e saj janë edhe ndryshimet në mësimdhënie e të nxënësve, e cila ka qëllim shndërrimin e klasës në një mjedis të gjallë, ku, në vend të dhënies së informacionit, kultivohen shprehjet për gjetjen, kërkimin e pavarur të tij, diskutohen çështje në këndvështrime të ndryshme, analizohen, identifikohen probleme, por edhe krijohen shprehjet e para sjelljet e para qytetare të nxënësve.

Shkolla është sistem i krijuar nga shoqëria për interesat e shoqërisë, prandaj asnjëherë nuk duhet ta humbasë kuptimin edukativo-arsimor dhe rregullimin e sjelljes qytetare.

Praktika të ndryshme të menaxhimit të sjelljeve të nxënësve në shkollë duhet të jenë strategji të suksesshme për të trajtuar problemet gjatë zhvillimit të procesit edukativo - arsimor, sepse në klasë paraqiten probleme të llojllojshme dhe të natyrave të ndryshme. Me to më së shpeshti ballafaqohen mësimdhënësit që punojnë në një klasë me nxënës të moshave të ndryshme, veçanërisht faza e adoleshencës që është një përballje më ndryshe. Gjatë kësaj kohe duhet të ruhet klima pozitive në mësim dhe të ndihmohen nxënësve që të prezantojnë një sjellje të pëlqyeshme në mjedisin e klasës ku ata kalojnë një pjesë të madhe të angazhimit aktiv të kohës së tyre.

Formulimi dhe kuptimi i plotë i konceptit, menaxhimi i sjelljeve të nxënësve, evidenton faktin e nevojës që duhet të ketë mësimdhënësi për të bashkëvepruar dhe për të realizuar integrimin e të gjitha strategjive të mundshme analitike-metodike - didaktike të administrimit, me qëllim që të arrijë të zgjedhë nga e tërë kjo mori strategjish, atë që është më e afërt dhe më aplikative për momentin në mjedisin e shkollës. Përgatitja e duhur dhe në nivel e më shumë strategjive menaxhuese të sjelljes së nxënësve nga ana e mësimdhënësit, është një veprim i suksesshëm, sepse i mundëson atij që, kur strategjia e parë nuk funksionon, të përdorë formën e dytë që të jetë e suksesshme në administrimin e klasës.

Përgatitja e duhur dhe në nivel e më shumë strategjive menaxhuese të sjelljes së nxënësit nga ana e mësimit është një veprim i suksesshëm, sepse i mundëson atij që, kur strategjia e parë nuk funksionon, të përdorë formën e dytë që të jetë e suksesshme në administrimin e klasës.

Studimi është i lidhur me mësuesit falë efektit që kanë llojet e ndryshme të mësimit që ata përdorin në sjelljet e nxënësve në klasë. Studimi gjithashtu ka potencialin të rrisë ndërgjegjësimin e mësuesve rreth menaxhimit të mësimit. Vendimmarrësit e arsimit janë ata që mund të reflektojnë, që, mbi bazën e përfundimeve të këtij studimi, të bëjnë të mundur ofrimin e tematikave trajnuese reale për mjedisin tonë arsimor e që lidhen me sjelljet e nxënësve në klasë.

Kur flasim për menaxhimin, shumica mendojnë për detyrat, përgjegjësitë, formulat buxhetore, të cilat i kalojmë gjatë kësaj periudhe, por edhe ballafaqimin me situata të ndryshme gjatë punës me nxënës.

Ky punim diplome mbështetet në hulumtimin veprues, i cili është një formë e hetimit vetëreflektues i ndërmarrë nga pjesëmarrësit në situata shoqërore. Ai përfshin edhe fushën arsimore për të përmirësuar të arsyetuarit e praktikës së tyre shoqërore apo arsimore, të kuptuarit për këto praktika dhe situata të cilat zbatohen.

Duke i shqyrtuar dhe vlerësuar punimet e autorëve të ndryshëm, artikujt shkencorë, atëherë vendosa që kjo të jetë tema e fokusit të këtij punimi, për të intervenuar me ndonjë strategji që do të përmirësonte aftësitë e nxënësve në ndikimin e menaxhimit të klasës në sjelljet e nxënësve.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Punim bazohet në kërkim primar, i cili konsiston në hulumtimin veprues, grumbullimin e informacioneve të nevojshme për të analizuar vështirësitë e nxënësve në ndikimin e menaxhimit në sjelljet e nxënësve, duke u bazuar në njohuritë e arritura në fushën e edukimit gjatë studimeve themelore dhe atyre të masterit. Ato do të përpiqem që t'i paraqes në mënyrë sa më complete.

Hulumtimin e kam përqendruar në ambientet e institucioneve që merren me problemet kryesisht të edukimit dhe me punë në bibliotekë. Analizën e këtyre të dhënave do ta bëjnë atë mënyrë që t'ju përshtaten aspektit mësimor në aspektin e menaxhimit të klasës në sjelljet e nxënësve.

Realizim i anketës si dhe vlerësimi i anketimit

Gjatë punës kam bërë trajtim të plotë, teksti të jetë i lidhur mirë dhe me të të ndiqet një rend logjik i ideve. Ai mbështetet në të dhëna të lidhura me temën, paraqitet objektivisht dhe të gjykohet i paanshëm për t'i arritur rezultatet e pritura.

Natyrisht, ky punim nuk mund të bëhet pa i mbledhur paraprakisht mendimet e studimeve që i kam konsultuar, veprat e të cilëve do t'i paraqes në bibliografinë e konsultuar.

Mbi të gjitha, do të jetë e një rëndësie të veçantë puna me mentorin tim, këshillat e të cilit do t'i ndjek me vëmendje dhe përpikëri.

PJESA E PARË

Kapitulli i parë

Si ta kuptojmë menaxhimin në klasë?

Fjala menaxhim rrjedh nga gjuha angleze (management), që ka kuptimin udhëheqje, prirje, pra nënkupton planifikimin, organizimin, udhëheqjen koordinimin dhe kontrollin e një organizmi për të arritur që një qëllim të caktuar¹.

Në Fjalorin e Shqipësisë së Sotme, të përafërt e me këtë nocion, e hasim fjalën administrim që do të thotë:

ADMINISTROJ kal. 1. Drejtoj dhe organizoj punën në një fushë a në një degë të ekonomisë ose të kulturës sipas rregullave dhe ligjeve të shtetit. Administron ekonominë. Administron mirë. 2. Kujdesem për një pasuri ose për një vlerë, që të përdoret mirë sipas rregullave ose sipas nevojave; qeverisë, mbarështoj; përdorë. Administroj vlerat (të ardhurat, fondet)².

Në arsim ka kuptimin që një mësues të administrojë, të drejtojë, të organizojë punën mësimore si dhe procesin mësimor në klasën e tij/saj, duke respektuar ligjet, (Rregulloren për sjellje dhe disiplinë të nxënësve për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën përkatëse) udhëzimet administrative, rregullat e shkollës (Rregulloren e shkruar të shkollës) si dhe rregullat e klasës.

Trajtimi teorik mbi menaxhimin e klasës dhe reflektimin rreth metodologjisë efektive për zbatimin praktik në klasë, janë dispozitat themelore me të cilat realizohet mësuesia e suksesshme.

Në përputhje me rregullat, të menaxhosh për një mësues do të thotë të kujdesesh për nxënësit si një vlerë shumë e rëndësishme për shoqërinë, e çmueshme, gjithnjë duke krijuar kushte dhe klimë për një edukim dhe arsimim të shëndoshë në përputhje me plan-programin mësimor dhe kurrikulën e arsimit.

Sipas interpretimeve teorike të “Metodologjisë së mësimit” e definojnë menaxhimin në këtë mënyrë”. Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe

¹Mikel Ndrecaj, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Rilindja, Prishtinë, 2000, f. 459.

²Fjalori i Shqipërisë së Sotme ASHSH, IGJL, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, f. 24.

organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënit duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim”³.

Por, nga përvoja ime tridhjetëvjeçare do të shtoja se administrimi i mirë i procesit mësimor varet edhe nga disa kritere, të cilat duhet t’i respektojnë mësimdhënësit për një administrim të mirë të procesit mësimor, si:

- Të njohë mirë ligjet dhe udhëzimet administrative për arsimin, dhe shkallën e kompetencave të tij.
- Të krijojë një atmosferë pune por dhe respekt në klasë.
- Të fitojë besim tek nxënësit
- Të krijojë klimë bashkëpunimidhe hapësirë për të gjithë nxënësit
- Në klasë të ketë rregullat e sjelljes
- Të informojë nxënësit me të drejtat,përgjegjësitë, detyrat
- Të krijojë marrëdhënie të shëndosha reciproke me prindërit e nxënësve.



³Brooks, J. G. M. G. Brooks (1999). In Search of Understanding The Case for Constructivist Classrooms. Alexandria, VA, USA. Association for Supervision & Curriculum Development. <http://site.ebrary.com/lib/akdeniz/Doc>.

Menaxhimi i klasës brenda një viti shkollor ka të bëjë me drejtimin e klasës, formimin e grupeve, fillimin dhe përfundimin e mësimit, ekologjinë e klasave, klimën e klasës, motivimin e nxënësve, vetitë e mësimit, komunikimin me nxënës etj.

Shpeshherë shtrohet pyetja: “menaxhim i klasës apo menaxhim i nxënësve”?

Edhe tek organizimi kemi dy polet e saj, organizimin e mirë dhe të keq të orës mësimore. Që të dyja ndikojnë në menaxhimin e klasës dhe kontrollin e nxënësve. Organizimi i mirë i rrjedhës së mësimit gjatë një ore mësimore nga mësimitdhënësi kërkohet që të zotërojë njohuri, shkathtësi, gatishmëri dhe, mbi të gjitha, largpamësi të parashikimit të të gjitha situatave të mundshme⁴.

Një formë e organizimit të klasës ka të bëjë edhe me organizimin e projekteve e iniciativave tjera jashtë kurrikulare me nxënës, si vizita pune jashtë shkollës, mësim jashtë shkollës (dhomës së mësimit), projekte të ndryshme individuale dhe grupore, prezantime me tema të ndryshme sepse menaxhimi i klasës është praktika dhe procedura që lejojnë mësuesin t’u mësojë nxënësve se si të nxënë edhe nga burimet tjera pos librit⁵. Menaxhimi i klasës përfshinë gjithçka që bën mësuesi për të organizuar nxënësit: kohën, materialet etj. në mënyrë që nxënësit të nxënë sa më mirë.

Rëndësi të veçantë gjatë menaxhimit të klasës ka edhe raporti mësues-nxënësi, i cili duhet të krijohet me një kujdes të veçantë, duke ruajtur distancën emocionale, por njëkohësisht duke u interesuar për pasionet e nxënësve, me përgatitje duke ndërtuar besim dhe duke komanduar sepse, nëse ne nuk e drejtojmë klasën si liderë, atëherë këtë pozicion ka gjasa ta përfitojë dikush nga nxënësit. Mësuesi ideal përdor teknika të ndryshme në mësim, ka një sens humori, i mban premtimet, ka dëshirë t’i dëgjojë të dy palët gjatë një problemi, përdor një ton të këndshëm, është miqësor, komunikon hapur, duke përdorur më shumë dialogun sesa monologun, nuk mban nxënësi të preferuar, është i sjellshëm gjatë gjithë kohës.- Shkruan Zajazi, T. Në Metodologji të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies.

⁴Verial, D., Types of Classroom Interaction e How Contributor | updated January 26, 2011 Volenski, L. T. & Rockwood, P. (1996). Family Environment and School Behavioral Problems [microform]/Leonard T. Volenski and Paul Rockwood Distributed by ERIC Clearinghouse,[S.l.]

⁵Zajazi, T. (2003). Metodologji të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies (Didaktika). Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Vinsent Graphic, Shkup.

Se sa arrijmë që të jemi administratorë të mirë të klasave tona, vlerësimin për këtë më së miri e japin vetë nxënësit, pastaj prindërit e kolegët tanë si dhe drejtorja e shkollës. Në këtë drejtim, për një sukses sa më të mirë gjithnjë kërkohet që të jemi vetëkritikë dhe të bëjmë vetëvlerësim të punës sonë.

Mësimdhënësi duhet vazhdimisht të mbajë shënime për suksesin, angazhimin dhe ngecjet e nxënësve në lëndë të ndryshme dhe brenda lëndëve në kapituj të ndryshëm. Kjo për qëllimin e vetëm që të ndihmojë që gjatë planifikimit dhe përgatitjes për të organizuar orën mësimore apo mësimin gjatë ditës të mos hasim në situata të pakëndshme e herë-herë të na dështojë krejt ora mësimore. Për të pasur një përgatitje sa më të mirë në organizimin e mësimit, mësimdhënësi duhet që të ketë njohuri të mjaftueshme mbi strategji të ndryshme të mësimdhënies, duke shikuar dhe analizuar se cilat teknika e forma të punës janë më të efektshme për njësinë mësimore konkrete dhe cila duhet të jetë forma e organizimit të punës së nxënësve.

Faktorët kryesorë në sjelljet e nxënësve

Janë shumë faktorë që ndikojnë në sjelljet e nxënësve, që reflektojnë drejtpërdrejt edhe në procesin mësimor, në mjedisin e përgjithshëm në shkollë. Ndër këta faktorë si më i rëndësishmi në këtë aspekt del të jetë familja, përkatësisht gjendja e saj e përgjithshme jo vetëm ekonomike, por edhe niveli arsimor. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në klimën përgjithshme në familje, e ajo drejtpërdrejt, nëpërmjet fëmijëve të tyre nxënës, reflekton në shkollë, në atmosferën epërgjithshme të saj dhe në punën e mësimdhënësve, qoftë kolektive a individuale me nxënës, që në mënyrë të ndjeshme ndikon në rezultatet e mësimnxënies dhe të shkollës në përgjithësi.

Kështu, nga shkaqet e jashtme të kësaj natyre mund t'i veçojmë:

- gjendja socio-ekonomike në familje,
- gjendja shëndetësore dhe psiko-fizike e nxënësve,
- rrethanat e përgjithshme shoqërore në arsimin e një vendi dhe
- paperspektiva ekonomike në vend.

“Sjellja mund të përkufizohet si mënyra si vepron njeriu në jetë, në shkollë, në shoqëri, në mjedise të ndryshme ose më lehtë mund ta definojmë si qëndrimi në marrëdhënie me të tjerët kundrejt detyrave në rrethana të caktuara”.⁴

Sjellja përfshin reagime mendore dhe fizike, të cilat gjatë procesit të punës tridhjetëvjeçare natyrisht që një mësimdhënës i has dhe, bashkë me to, vijnë edhe teknikat të ndryshme, të cilat evidentojnë sjelljet negative.

Një ndër faktorët kryesorë që ndikon në sjelljet e fëmijëve janë edhe qëndrimet e prindërve. Në të vërtetë nocionet rreth mënyrës së drejtë të rritjes dhe edukimit të fëmijës ndryshojnë me kohë, kështu që çfarë është e “drejtë” për një gjeneratë, për një gjeneratë tjetër mund të jetë e “gabuar”. Po ashtu, bashkë me të edhe filozofia bazë, themelore e rritjes së fëmijës gjithashtu pëson ndryshim, për një periudhë kohe të paktën deri vonë, në kohët tona lëvizja e përgjithshme ishte drejt tipit autoritativ të rritjes dhe edukimit të fëmijës.

Roli i prindit përfshin padyshim më shumë se një vijimësi të veprimeve të veçanta, cilësitë dhe karakteristikat e tij si person do të kenë një mbështetje të rëndësishme në performancën e tij si prind.

Nga studimi i Bekerns-it konkludojmë se fëmija ndikohet më shumë nga cilësia e “strukturës së karakterit” të nënës dhe të efekteve të saj në “bashkëveprimin total nënë-fëmijë” sesa nga praktikat dhe teknikat e mirërritjes specifike të fëmijës, por natyrisht nuk është vetëm personaliteti i nënës që është vendimtar, personaliteti i babait është gjithashtu pjesë e rëndësishme e kësaj tabloje⁶.

Fëmijët po ashtu janë të aftë të tregojnë tipare individuale të dukshme, gati-gati që nga momenti i lindjes. Njëri prej çiftit të binjakëve identikë mund të jetë që nga fillimi më i uritur dhe më kërkues sesa tjetri.

~~“Pavarësisht nga personaliteti i nënës ose struktura e karakterit, ajo ka mundësi të merret në mënyrë të diferencuar me një fëmijë të ashpër sesa me një fëmijë sensitiv”⁷.~~

Fakti se marrëdhënia prind-fëmijë është interpersonale nuk mund të hulumtohet thjeshtë duke parë sjelljen prindërore si shkak dhe personalitetin e fëmijës si efekt është harruar e lënë mbas dore.


⁶Musai, B. (1999). Psikologji edukimi (zhvillimi, të nxënët, mësimdhënia), Shtëpia botuese dhe shtypshkronja PEGI, Tiranë.

⁷Barker, L. L. (1982). Communication in the Classroom. Prentice Hall Inc. Englewoods Cliffs.

Nga ana psikologjike tek sjelljet e prindërve dhe relacioni i tyre me fëmijë thuhet se prindi psikologjik përpriqet, për aq sa është në gjendje të kuptoj përpara se të gjykojë ose të ndëshkojë, ai kërkon për aq sa i lejon guximi i tij emocional të rrëmojë ankesat, zemërimin, dekurajimin dhe pakënaqësinë e fëmijës së tij.⁸

“Ai është veçanërisht me fat, dhe po kështu janë ata nën kujdesin e tij, nëse është i aftë, pa vetë-akuzim të tepruar, të pranojë gabimet e tij, të pranojë veten si një person që natyrshëm ofron më pak se njëprind perfekt, të qëndrojë kundër atyre që do ta etiketonin atë si prind “braktisës” kurgjërëta shkojnë keq, ta shikojë veten si një person, i cili gjatë gjithë ecurisë për të qenë prind nëmënyrë të paevitueshme hera herës do të jetë i zemëruar, i paduruar, nervoz, i pavendosur, konfuz dhe i pasigurt”⁹.

Një prind me të tilla qëndrime do të pranojë tekvetja se ndodh ndonjëherë kur ai dëshiron që fëmijët e tij t’i hiqen qafe dhe ai mund të lejojë veten të jetë skeptik, tani dhe më vonë nëse do të jetë në gjendje që ndonjëherë të bëhet prind.



Sistemi më i zakonshëm i klasifikimit të stileve prindërore përdor dy dimensione ortogonale të rreptësisë prindërore (kontrolli i sjelljes, mbikëqyrja, kërkesa e pjekurisë) dhe përgjegjshmërisë (ngrohtësia, pëlqyeshmëria, angazhimi), me nënklasifikim në katër stile prindërimi¹⁰.

⁸Problemet emocionale dhe të sjelljes tek fëmijët dhe adoleshentët që marrin shërbim në klinikën e Psikiatrisë së fëmijëve/adoleshentëve QSUT “Nënë Tereza”, Valmira Skëndi, 2016.

⁹Musai, B. (2003). Metodologji e mësimdhënies, PEGI, Tiranë.

¹⁰Gelfand, D.M. & Hartmann, D.P. (1975). Child behaviour: analysis and therapy. New York: Pergamon Press. George, C. L. (2010). Effects of response cards on performance and participation in social studies for middle school students with emotional and behavioral disorders. Behavioral Disorders, 35, f. 214-228.

1. Urdhërues, me rreptësi dhe përgjegjshmëri të lartë.
2. Autoritar, me rreptësi të lartë dhe përgjegjshmëri të ulët.
3. Lejues, me rreptësi të ulët dhe përgjegjshmëri të lartë.
4. Neglizhues, me rreptësi të ulët dhe përgjegjshmëri të ulët.

Në listën e faktorëve që ndikojnë në sjelljet e nxënësve janë edhe faktori “ndarja nga prindërit, e cila në ecurinë normale të zhvillimit shumë fëmijë shfaqin frikë dhe forma tjera të shqetësimit kur ndahen nga prindërit e tyre. Kur mungesa e parakohshme e prindërve, hospitalizimi dhe mungesa e gjatë shoqërohen me shqetësim të fëmijëve natyrisht se hasim në vështirësi emocionale dhe ndryshim të sjelljes tek fëmija.

Nuk ka asnjë model të vetëm apo definitiv të prindërimit. Çfarë mund të jetë e drejtë për një familje ose një fëmijë mund të mos jetë e përshtatshme për një tjetër.

A ndikojnë këta faktorë në sjelljen e nxënësit në klasë?

Po, pa diskutim që ndikojnë dhe mësimdhënia jo atraktive sepse një prej kërkesave thelbësore të mësimdhënies bashkëkohore është realizimi i një mësimdhënieje atraktive me nxënës në klasë, si parakusht për motivimin e duhur të nxënësve për mësim. Motivimi jo i mjaftueshëm i nxënësve nga mësimdhënësi ndikon drejtpërdrejt në angazhimin, përkatësisht mosangazhimin e nxënësve për mësim ose, thënë më ndryshe, ndikon dukshëm në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në procesin mësimor në klasë, pra për të qenë aktivë gjatë këtij procesi si dhe për të treguar shenja pasiviteti në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Komunikimi transparent, konkret dhe i plotë është çelës për të krijuar këtë partneritet me të gjitha organet e nevojshme, të cilat janë në interes të shkollës dhe të bashkësisë së gjerë. Në mënyrë që komunikimi të realizohet me sukses, gjithsesi duhet paraprakisht të përgatitet plani për komunikimin, në të cilin duhet të merren parasysh shumë aspekte, si formati i komunikimit, personat me të cilët duhet komunikuar, përzgjedhja e strategjive më të përshtatshme për komunikim, afatet kohore dhe subjektet e ngarkuara për komunikim.

“Interesimi i nxënësve për mësim duhet të ketë një komunikim të qëndrueshëm, konstruktiv dhe të rregullt, nëradhë të parë në mes të vetë organeve të shkollës, e pastaj edhe mes faktorëve të tjerë. Në këtë kontekst një komunikim i efektshëm mes mësimdhënësve dhe nxënësve është parësor dhe thelbësor, duke vazhduar edhe me prindërit e nxënësve, sepse koncepti i një shkolle demokratike dhe bashkëkohore kërkon vënien e të drejtave të fëmijëve në qendër të shkollës”¹¹.

Udhëheqja e mirë dhe e ekuilibruar ka rëndësi për një shkollë të suksesshme, sepse kjo reflekton drejtpërdrejt dhe mbi të gjitha në suksesin e përgjithshëm të nxënësve dhe në arritjet dhe rezultatet e kënaqshme të tyre. Sjellja e mësimdhënësve në shkollë, e veçanërisht në klasë, në raport me nxënësit, ka rëndësi të madhe, ngase qasja e tij ndaj tyre ndikon drejtpërdrejt në motivimin ose në demotivimin e tyre për mësim. Një mësimdhënës emotiv, impulsiv a me qëndrime të ashpra ndaj nxënësve, krijon klimë jo të përshtatshme në klasë, demotivim për mësim dhe neglizhim të nxënësve ndaj procesit mësimor dhe shkollës në përgjithësi.

Nxënësit i spikatin këto cilësi të personalitetit të mësimdhënësit dhe kjo ndikon në qëndrimin e tyre ndaj shkollës, prandaj s'ka dyshim se qëndrimi i afërt, i ngrohtë dhe me takt i mësimdhënësve ndikon në afërsinë e nxënësve ndaj shkollës, në krijimin e një klime të favorshme dhe në suksesin e përgjithshëm në mësimnxënie.¹¹

¹¹Muharremi, A. (2013). Menaxhimi mësimor, p.41-53.

“Kur përmendim faktorët që ndikojnë në sjellje të nxënësve, natyrisht ato lidhen edhe me disiplinën që është një element tjetër për humbjen e interesimit, njëherësh edhe sjelljen e nxënësit qysh nga premisat e para të rregullave shkollore si mbajtja e rregullt e uniformës a respektimi i kujdestarive të ndryshme nga nxënësit në objektet shkollore, duke mos pasur një ndjeshmëri tolerance, herë-herë rëndojnë klimën e përgjithshme në shkollë, sado që e tërë kjo bëhet në emër të krijimit të një mjedisi sa më të përshtatshëm dhe të një rendi shtëpiak në shkollë”¹².

Në këto angazhime organet drejtuese të shkollës duhet të jenë të matura dhe të tregojnë një shkallë tolerance, ngase në të kundërtën arrihen efektet e kundërta me ato të synuara¹³.

¹²Doyle, W. (1986). “Classroom Organisation and Management”. Handbook of Research on Teaching. Ed. Merlin C. Wittrock, Third Ed. Macmillan Pub. Comp. New York.

¹³Becher, R. (1993). “The Aesthetic Classroom Environment and Student Attitude Toward School”. Dissertation Abstracts International. Vol.53. No.9. p. 37-41.

Konkluzione të tilla dalin nga bisedat me nxënës dhe me prindër, të cilët, sado që e mbështesin një rend dhe rregull në shkolla, kanë edhe ankesa konkrete nga teprime të ndryshme të kësaj natyre. E kjo, padyshim, ndikon edhe në (jo)motivimin e nxënësve për procesin e përgjithshëm mësimor në shkollë, dhe në sjelljet e tyre.

Nga të gjitha vrojtimet e bëra dhe format e tjera të kontaktit me nxënës dhe mësimdhënës ka dalë se një prej shkaqeve që në një mënyrë ka presion të drejtpërdrejtë në sjelljet e nxënësve është edhe kontakti i tyre me nxënës problematikë, të cilët sikur kanë aftësi të veçantë që të përvetësojnë fëmijë në rrjetin e tyre të sjelljes e të veprimit të përditshëm.

Kjo manifestohet sidomos te një kategori nxënësish me qëndrime të luhatshme, pa një karakter të fortë dhe pa ndonjëmbikëqyrje të veçantë nga prindërit.

Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me ta, një fëmijë me temperament të ndjeshëm, që manifeston sjellje agresive, sjellje antisociale, apo angazhim në aktivitete me rrezikshmëri, qoftë edhe të një shkalle jo tepër të lartë, sikur është i prirë që të bashkojë rreth vetes fëmijë të tjerë, ndaj të cilëve do të mund të ushtrojë jo vetëm presion nëveprime të caktuara, por edhe autoritetin e tij, si “lider” i pakontestueshëm dhe si qendra e organizimit të çdo aktiviteti.

Pra, faktorët që ndikojnë në sjelljet e nxënësve, mund të jenë:

- Familja (niveli i ulët i edukimit në familje);
- Sjellja jokorrekte e mësimdhënësve në shkollë,
- Gjendja emocionale-psikologjike e fëmijës,
- Vullneti i kundërshtimit të nxënësve nga padrejtësia,
- Raporti me fëmijët e tjerë,
- Mospërgatitja e mësimdhënësve ndikon në zvogëlimin kureshtjes së nxënësve,
- Puna në grupe, në aktivitete të ndryshme dhe bashkëpunimi me prindër dhe nxënës;
- Roli i pedagogut – psikologut, ka rëndësi të madhe në ngritjen e interesimit të nxënësve për mësim, sidomos kur sot mungon ora e kujdestarisë dhe është numri i madh i nxënësve në klasë.

Kapitulli i dytë

Menaxhimi i klasës sipas standardeve pedagogjike

Jo vetëm në lëmin e arsimit, por edhe në lëmenjtë e tjerë standardet pedagogjike janë një përpjekje komplekse e bazuar në praktikë, ku, në rastin tonë, palët e interesit arsimor (mësimdhënës-pedagog-drejtor) kanë interes një metodë të përbashkët shkëmbim përtej kufijve, gjuhëve, kodeve, vendeve, metodave, filozofive, ku deri në paraqitjen e internetit ky shkëmbim ka qenë shumë i vështirë, kurse sot më shume kemi të bëjmë me standardet të digjitalizuara në aspektin e gjithëpërfshirjes, sepse mësimdhënësit janë në kërkim të ndarjes së modeleve mësimore, planeve javore, planeve dy mujore, planeve vjetore, strategjive tjera që ndikojnë në mësimdhënie, menaxhim shkolle¹⁴.

Kjo po arrihet shumë lehtë me anë të teknologjisë, sepse shërbimi elektronik teorikisht përfshinë informacione të të gjitha formave të mësimit shumë komplekse dhe fleksibile për mësim cilësor, sepse derisa numri i mësuesve rritet, shohim edhe zhvillues dhe profesionistë të IT-, duke luajtur rolin mbështetës në bashkëkrijimin e këtyre standardeve¹⁵.

Për të arritur tek menaxhimi i klasës sipas standardeve pedagogjike, hallka e këtij punimi duhet të kalojë nëpër Standardet e drejtorit të shkollës dhe Standardet e mësimdhënësit.

¹⁴Brophy, J. & Good, T. (1986). Teacher Behavior and Student Achievement. In M. Eittrock (Ed.) Handbook of Research on Teaching (3rd ed). Macm.

¹⁵Charles, C.M. (2005). Building Classroom Discipline. Collaboration by Gail W Senter. Emeritus San Diego state university. Eight edition.

Standardet si drejtor shkolle-menaxher i një institucioni i arsimor

- Të këtë njohuri me teoritë kryesore të drejtimit të menaxhimit, praktika të sukseshme.
- Të njohë aspektet e legjislacionit dhe dokumentet kryesore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt a tërthorazi me arsim (Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligje, Rregullore, Vendime, Kartën Evropiane të Drejtave të Njeriut, Konventën e Të Drejtave të Fëmijëve, Udhëzime, Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Kurrikulën Bërthamë) dhe të përcjellë risitë arsimore në këto dokumente.
- Të ndërtojë strukturën e shkollës të përbërë nga zëvendës-drejtori, mesimdhënësit, psikologu i shkollës, pedagogu, këshilli i shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve.
- Të konkretizojë planet punës së tij, me analiza të sakta të plota sistematike, të matshme, ambicioze dhe të kontrollueshme.
- Të jetë bashkëpunëtorë në dobi të nxënësit, prindërit, përfaqësuesve të prindërve, zyrës arsimore komunale.



-Të bartë vlera etike të sjelljes, të gëzojë shëndet moral, qëndrime të drejta etike të sjelljes.

Këto standarde orientojnë dhe ndihmojnë drejtorët në të gjitha proceset e shkollës për të arritur qëllimin që është cilësia në shkollë, puna e drejtorëve të shkollave me anë të këtyre standardeve mundëson bashkëpunim, inkurajim për udhëheqje të përbashkët që të bëjë atë që është më e mira për shkollën e tyre.

Standardet gjithashtu përcaktojnë një pikë të përgjithshme të sistemit të vlerësimit të performancës së drejtorëve të shkollës.

Standardet e mësimdhënësit

-Përgatitja arsimore-shkencore

-Të njoh aspektet e legjislacionit dhe dokumentet kryesore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt a tërthorazi me arsim (Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligje, Rregullore, Vendime, Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Konventën e Të Drejtave të Fëmijëve, Udhëzime, Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Kurrikulën Bërthamë) dhe të përcjell risit arsimore në këto dokumente.

- Zhvillim profesional (Mësimdhënësi vazhdimisht gjatë punës së tij/saj reflekton në punën e tij me literaturë të re, trajnime)

-Mësimdhënia dhe mësimnxënia (Mësimdhënësi përdorë strategji dhe praktika të ndryshme)

-Përkujdesja për nxënësit me vështirësi në të nxënë (bashkëpunimi me prindër-psikolog-pedagog)

-Vlerësimi i të nxënit (Vlerësimi i procesit dhe rezultatet e të nxënit, kompetencat themelore, standardet dhe e të nxënit dhe objektivat e programeve lëndore.)

-Bashkëpunimi me komunitetin

-Etika dhe sjellja (të respektoj të drejtat e njeriut, krijimi i mjedisit të punës, respekt.)

Këto janë disa nga standardet e një mësimdhënësi bashkëkohor, pa dashur të kufizojmë origjinalitetin e mësimdhënësimit, por ta nxisim.

Standardet e mësuesit ia lehtësojnë mjaft punën drejtorit të institucionit arsimor dhe të gjitha këto janë të ndërlidhura me menaxhimin e klasës sipas standardeve pedagogjike.

Menaxhimi i klasës është një term që mësuesit përdorin për të përshkruar procesin që zhvillohet normalisht. Ai mbështetet në zbatimin e duhur të zhvillimit të kurrikulumit, zhvillimin e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe vënien në veprim¹⁶.


Menaxhimi i klasës mund të shpjegohet si veprim dhe udhëzim që mësuesit përdorin për të krijuar një mjedis të suksesshëm të nxënësve.

Menaxhimi i klasës, sipas standardeve pedagogjike, është i lidhur ngushtë me çështjen e motivimit, disiplinës dhe respektit, sepse metodologjitë mbeten çështjen e debatit të pasionuar midis mësuesve. Një pjesë më madhe e menaxhimit tradicional ka në lidhje me psikologjinë arsimore sepse praktika të mira ndikojnë në krijimin e klimës pozitive në klasë. Për krijimin e klimës pozitive në klasë me rëndësi të veçantë është edhe rregullimi apo radhitja e bankave/ulëseve dhe tavolinave¹⁷.

Minimizimi i lëvizjeve nëpër klasë ka rëndësi sepse ndikon në zvogëlimin e mundësive për shkaktimin e prishjes së rendit dhe qetësisë, por edhe krijimin e pengesave që mund të shkaktojnë nxënësve kur lëvizin për të marrë materialet, për të vendosur librat ose mjetet tjera. Sipas Coming (2000) që e hasim edhe tek Kërkime pedagogjike –Përmbledhje punimesh (2) nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, ka disa ide për formën e radhitjes së bankave në klasë.


¹⁶Cummings, C. (2001). Strategies for Classroom Management. Teaching, inc. Virginia, USA.

¹⁷Harris, A. H. (1991). "Proactive classroom Management: Several Ounces of Prevention". Contemporary Education. Vol. 62. No.3.(pp. 156-160).




Forma në çift, e cila mundëson shmangien e përplasjes së nxënësve me njëri-tjetrin, por edhe ndikon në kontrollimin e zhurmës, që vetëm nxënësit e rendit të parë kanë frekuencë më të gjatë të komunikimit, ndërveprimi me mësuesin, i cili kohën më të gjatë e kalon para tyre. Po ashtu, është formë jo e përshtatshme për fëmijë që kanë probleme në shikim dhe dëgjim.

Forma në katërshe apo në grupe, e cila mund të jetë efektive për nxënësit më pak aktivë, kjo mundëson që nxënësit, në bazë të njëri-tjetrit, të përfitojnë më tepër nga mësimi.



Forma U, e cila krijon hapësirë të gjerë në klasë, sepse është e rëndësishme që gjatë rregullimit të bankave në klasë të kemi në mendje lirinë e lëvizjes së nxënësve.




Dhe forma e fundit është Trajta U plus rreshta. Për këto forma të rregullime të bankave nuk do të thotë të jetë i përhershëm. Në menaxhimin e klasës natyrisht duhet të respektohet Rregullorja e shkollës, rendi shtëpiak, dhe rregullat e klasës.

Ka shumë mësimdhënës që ngatërrojnë menaxhimin e sjelljes tek menaxhimi i klasës meqë kjo e fundit përkufizohet si term më i gjerë, kurse menaxhimi i sjelljes më shumë është strategji për shqyrtimin e problemeve, ndërhyrjet efektive tek fëmijët.

Kjo ngase dy fëmijë me sjellje të këqija mund të kërkojnë krejtësisht strategji të ndryshme për vazhdimin e orës mësimore, pa ngritur zërin dhe pa dëmtuar marrëdhënien mësues-nxënës dhe të cilat shpjen deri tek mosfunksionimi i klasës¹⁸.

¹⁸Musai, B. (2005). Mësimdhënia dhe të nxëniti ndërveprues: modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve: cikli fillor, CDE, PEGI, Tiranë.

Dhe këtë formë të radhitjes së nxënësve:



Mësimdhënësit duhet të jetë në përputhje me pritjet dhe pasojat e tyre për të ndihmuar që studentët të kuptojnë se rregullat duhet të zbatohendhe, në mënyrë të qartë, të angazhohen në nivel të mjaftueshme për procedurat e menaxhimit të klasës për t'i zbatuar vazhdimisht¹⁹.

Në menaxhimin e klasës natyrisht ndikojnë edhe veçoritë-tiparet kryesore të një mësimdhënësi, por edhe ana teknike siç është prezente në shkollën tonë numri i standard i nxënësve nëpër klasë, përgatitja teknike e dhomës së punës (klasës) etj.

¹⁹Yang, K. M., & George, S. (1995). The effects of Self – Evaluatiaon, Self – Observation, and Self – Observation plus Self – Recording on the Occurrence of Disruptive Behaviors in Classroom: Extencion Study, ED 385 028.

PJESA E DYTË


Kapitulli i tretë

Rezultatet e pyetësorit të mësimdhënësve:

Këtij pyetësori u janë përgjigjur **tridhjetë (30)** mësimdhënës.


Si do të duket pjesa e konkluzionit? Për përgjigje kryesore do të përdoret grafiku si më poshtë:

Pyetja: 1. Unë e di kuptimin e menaxhimit të klasës




Tridhjetë (30) mësimdhënës janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje. Çka do të thotë se ajo çka kemi trajtuar në pjesën e parë të kësaj teze, lidhur me kuptimin e menaxhimit të klasës, kjo pyetje për mësimdhënësit, sipas grafikorit na tregon se të gjithë të anketuarit janë të vetëdijshëm dhe të informuar se çka do të thotë menaxhimi i klasës.

Pyetja: 2. Menaxhimi i klasës ndikon në procesin mësimor.




Nga tridhjetë (30) të anketuar, përgjigjja se a ndikon menaxhimi në procesin mësimor, të anketuarit kanë zgjedhur vetëm dy nga alternativat e dhëna, pesë (5) persona janë përgjigjur se ndikon **mesatarisht**, ndërsa njëzetepesë (25) janë përgjigjur se ndikon **shumë**. Këtu qëndron në fakt i gjithë qëllimi që menaxhimi të ndikojë në procesin mësimor.

Pyetja: 3. Sa ndikon pozitivisht monitorimi i përformacës në orët tuaja, në aspektin e menaxhimit të klasës?




Nga grafikoni kuptojmë që pesëmbëdhjetë (15) nga të anketuarit janë shprehur se monitorimi i përformacës ndikon **shumë** në menaxhimin e klasës, dymbëdhjetë (12) persona janë shprehur se ndikon **mesatarisht**, dy (2) persona **aspak**, dhe një (1) mendon se ndikon **pak**.

Pyetja: 4. Sa bashkëpunoni me kolegët tjerë?




Tridhjetë (30) nga të anketuarit në pyetjen e 4, janë përgjigjur se bashkëpunimi me kolegët ekziston në këtë proporcion, **shumë** vetëm (12) persona, **mesatarisht** gjashtëmbëdhjetë (16) dhe **pak** vetëm dy (2) vetë.

Pyetja: 5.Sa mendoni që kanë ndikim mësimitdhënësit e tjerë në menaxhimin e klasës?




Në këtë pyetje, trembëdhjetë (13) të anketuar kanë votuar se mësimitdhënësit e tjerë kanë ndikim **shumë** në menaxhimin e klasës, **mesatarisht** kanë votuar pesëmbëdhjetë (15) dhe **pak** vetëm dy (2) të anketuar.

Pyetja: 6. A mbani seanca diskutimi, aftësimi dhe reflektimi për zbatimin e Rregullores së shkollës?




Duke ditur rëndësinë e seanceve, diskutimeve, të anketuarit janë pozicionuar se ato ndikojnë **shumë**:njëmbëdhjetë (11) persona, **rrallë** tre (3) dhe **nganjëherë** gjashtëmbëdhjetë (16) nga të anketuarit.

Pyetja: 7. A i shfrytëzoni këto diskutime/reflektime për planifikimin e zhvillimit tuaj profesional ?




Nga tridhjetë (30) të anketuar, pesëmbëdhjetë (15) janë përgjigjur se këto reflektime ndikojnë **shumë**, **mesatarisht** trembëdhjetë (13) dhe **pak** vetëm dy (2).

Pyetje: 8. A keni marrë pjesë në orën e ndonjërit kolegë nga aktivi juaj (sa shpesh)?




Në pyetjen e tetë (8), të anketuarit janë përgjigjur si në këtë grafik, katërmbëdhjetë (14) **nganjëherë**, **asnjëherë** pesë (5) dhe **rrallë** njëmbëdhjetë (11) nga të anketuarit.

Pyetje: 9. A ka pasur rast që ndonjëri prej kolegëve tuaj të kërkojë ndihmë për menaxhimin e klasës?




Lidhur me rastet e ndihmës nga kolegët për menaxhimin e klasës, të anketuarit janë shprehur se ka pasur raste **shpesh** katër (4), **nganjëherë** njëmbëdhjetë (11), **rrallë** dhjetë (10) dhe **asnjëherë** pesë (5).

Pyetje:10. A ka pasur rast kur keni kërkuar ndihmë për menaxhimin e klasës?




Të anketuarit kanë pasur rast të kërkojnë ndihmë për menaxhimin e klasës si në vijim nga tridhjetë (30) të anketuar, **rrallë** herë vetëm tetë (8), **asnjëherë** nuk kanë kërkuar ndihmë vetëm trembëdhjetë (13) dhe **nganjëherë** nëntë (9) persona.

Pyetje: 11. Marr informata nga Drejtori i shkollës për më të rejat teknikat, rregulloret e reja për menaxhimin e klasës.




Të rejat nga rregulloret për menaxhimin e klasës mësimdhënëset i marrin, **shpesh** pesëmbëdhjetë (15) të anketuara, **rrallë** katër (4) nga të anketuarat dhe nganjëherë njëmbëdhjetë (11).

Pyetje: 12. Për menaxhimin e klasës, mësimitdhënësi duhet të ketë zhvillim profesional të caktuar, për lëndën përkatëse.




Në pyetjen e dymbëdhjetë 12, **jo** janë përgjigjur vetëm katër (4), **s'ka rëndësi** tre(3), **ndoshta** shtatë (7), dhe **po** janë përgjigjur gjashtëmbëdhjetë (16).

Pyetje: 13. Për menaxhimin e klasës,mësimitdhënësi duhet të përdor strategji dhe praktika të ndryshme në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie.




Për menaxhimin e klasës mësimitdhënësit duhet të përdorin strategji dhe praktika të ndryshme në mësimitdhënie, të anketuarit janë pozicionuar se **po** ka rëndësi të madhe njëzet e tetë (8) persona, dhe **s'ka rëndësi** dy (2) persona.

Pyetje: 14. Për menaxhimin e klasës, mësuesimdhënësi duhet të ketë raporte të mira me drejtorin e shkollës.




Mësuesimdhënësit duhet të kenë raporte të mira me drejtorin e shkollës, **po** kanë menduar nëntëmbëdhjetë (19) persona, **s'ka rëndësi** gjashtë persona, **ndoshta** tre (3) dhe **jo** vetëm dy (2) persona.

Pyetje: 15. Për menaxhimin e klasës mësuesimdhënësi duhet të ketë raporte të mira me pedagogun.




Lidhur me raportet e mira më pedagogun e shkollës, mësuesimdhënësit mendojnë se ka rëndësi **po** shtatëmbëdhjetë (17), **s'ka rëndësi** shtatë (7) persona, **ndoshta** katër (4), dhe **jo** dy (2).

Pyetje: 16. Për menaxhimin e klasësmësimdhënësi duhet të ketë raporte të mira me prindër.




Në pyetjen lidhur me raportet me prindër ja si kanë votuar të anketuarit, **po** duhet të kenë raporte të mira njëzetë e katër (24), **ndoshta** tre (3) dhe **s'ka rëndësi** raporti prind dhe menaxhues kanë votuar tre (3) mësimdhënës.

Pyetje: 17. Për menaxhimin e klasës, mësimdhënësi duhet të respektoj të drejtat e njeriut, krijimin e mjedisit të punës.




Mësimdhënësit kanë zgjedhur **po** si shumicë njëzetë e nëntë (29) dhe vetëm një (1) mësimdhënës ka zgjedhur **ndoshta**.

Pyetje: 18. Menaxhimi i klasës përfshinë gjithçka që bën mësuesi për të organizuar nxënësit, kohën, materialet në mënyrë që nxënësit të nxënë.




Pajtueshmëria mbi këtë qëndrim se menaxhimi i klasës, përfshijnë gjithë organizimin, kohën dhe materialet, mësime nxënësit janë shprehur me **po** njëzet e tetë (28) dhe **ndoshta** vetëm dy (2).

Pyetje: 19. Mësimdhënësi duhet vazhdimisht të mbajë shënime për suksesin, angazhimin dhe ngecjet e nxënësve në lëndë të ndryshme dhe brenda periudhave të ndryshme.




Mësimdhënësit pajtohen më këtë qëndrim, po njëzet e nëntë (29), dhe ndoshta vetëm një (1)

Pyetje: 20. Mësimdhënësi duhet vazhdimisht të mbajë shënime për ndryshimin e sjelljes tek nxënësi.




Mësimdhënësit **pajtohen** të gjithë tridhjetë (30), se të gjithë duhet vazhdimisht të mbajnë shënime për ndryshime sjelljes tek nxënësi.

Pyetje: 21. Mësimdhënësi duhet të mbajë shënime për vërejtjet që i shqipton gjatë procesit mësimor.



Në këtë pyetje janë pajtuar **po** njëzetë e shtatë (27) të anketuar, dhe vetëm tre (3), prej tyre kanë zgjedhur **ndoshta**.

Pyetje: 22. Për të pasur sukses procesi mësimor, duhet të përfilllet Rregullorja e shkollës për sjelljet e nxënësve dhe mësimitdhënësve.



Në këtë pyetje të gjithë mësimitdhënësit janë pajtuar se procesi mësimor i suksesshëm duhet të përfilllet në bazë të Rregullores për sjelljen e nxënësve, tridhjetë të anketuar kanë zgjedhur opsionin **po**.

Pyetje: 23. Çka do të ndryshonit ju në Rregulloren e shkollës?

-Si disa nga ndryshimet më të rëndësishme që do të mund të ndryshonin mësimitdhënësit janë?

- Numri i nxënësve të reduktohet në 20-27 nxënës në klasë.
- Rregullat të zbatohen nga nxënësit por edhe nga mësimitdhënësit.
- Të theksohen masat ndëshkuese për nxënësit e padisiplinuar.
- Disiplina të jetë në nivelin e lartë.
- Në kushtet dhe rrethanat në të cilat jetojmë, shpresoj që kushtet mësimore të ndryshojnë dhe të përmirësohen në një të ardhme të afërt.
- Përgjegjësi dhe disiplinë më shumë.
- Të respektojnë rregullat e shkollës sa më shumë që është e mundur.
- Masa të reja ndëshkuese.
- Nxënësit t'i kuptojnë përgjegjësit e tyre dhe t'i respektojnë ato në praktikë.

- Rregullorja e shkollës përfshin të gjitha etapat e zhvillimit që duhet të përmbajë një shkollë, konsideroj që ajo vetëm duhet të rishrkuhet dhe ripërtërihet çdo vit.
- Asgjë nuk do të ndryshojë, varësisht nga situata që na paraqitet në momente të caktuara kërkojmë që të na jepet hapësirë në raste përjashtuese të mund të veprojmë me ndryshe.
- Të jemi më të përpiktë, në zbatimin e rregullores së shkollës, t'i lavdërojmë ata që e respektojnë rregulloren e shkollës, dhe të përdoren masa ndëshkuese alternative për ata që nuk e përfillin rregulloren.
- Vetëm të respektohet nga të gjithë.
- Diskutime më të shpeshta me nxënësit dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes së Rregullores së shkollës.
- Të jemi më interaktivë dhe jo shumë formalë në bashkëpunim me nxënësit.

24.Cilat janë disa nga sekretet e punës suaj për menaxhimin sa më cilësor të klasës(si kujdestar klasë) dhe si mësimdhënës?

Përgjigjet e mësimdhënësve:

- Përgatitja profesionale, vullneti për punë me nxënësit.
- Takimet e shpeshta me prindër, diskutimet e problemeve bashkërisht me nxënësit, kjo ka ndikuar në menaxhimin e mirë të klasës.
- Puna efektive dhe mirëkuptimi, kjo e fundit ka shumë rol të rëndësishëm.
- Krijimi i atmosferës së punës (mbajtja në nivel të disiplinës), ora të jetë atraktive dhe interesante.
- Të jemi të afërt ndaj nxënësve në mënyrë që ata ta ndiejnë veten përgjegjës dhe të respektuar.
- Përvoja dhe eksperiencia të ndryshme të punës me gjenerata të ndryshme,
- Risitë në klasë
- Bashkëpunimi
- Afërsia me nxënësit.
- Aktiviteti, përcjellja e situatës, disiplina në procesin mësimor,
- Mësimdhënia dhe mësimnxënia të jetë e drejtë, e sinqertë dhe komunikim i hapur;
- Bashkëpunimi me nxënësit, prindërit, mësimdhënësit e tjerë, duke formuar kështu trekëndëshin pedagogjik.
- Besimi tek vetja, krijimi i raporteve të mira me nxënësit.
- Bashkëpunimi me kolegët, stafin e shkollës që të krijojmë një klimë të përshtatshme mësimi dhe arritje suksesi për ta.
- Përgatitja e rregullt e planit ditor, vjetor për çdo mësim, përgatitje shtesë, aktivitetet etj.
- Respekti ndaj njëri tjetrit, respektimi i rregullores së shkollës, liria e shprehjes dhe komunikimi i rregullt.
- Kërkimi nga nxënësit që të zbatojnë rregullat e klasës, disiplina dhe realizimi i planit mësimor.

25.A ndikon sjellja e nxënësve në menaxhimin e klasës? A mund të na cekni një rast të tillë?

Kësaj pyetje të hapur, mësimdhënësit u janë përgjigjur si më poshtë:

- Ndikon shumë.
- Një sjellje e nxënësit hiperaktivë, e cila përsëritet pa ndërprerje, kuptohet që pengon në menaxhim. Me nxënës të tillë duhet të merren masa të ndryshme jo vetëm nga kujdestari por edhe nga drejtorja e shkollës.
- Sigurisht se ndikon, unë shqetësohem shumë për nxënësit e mi, ngase disponimi im varet nga shume raste që i kemi ne klasë, mirëpo e marr me përgjegjësi detyrën time dhe prandaj arrij aty ku dua.
- Kam pasur raste të vështira për t'i menaxhuar klasën, mirëpo pas një organizimi të mirë, dhe angazhimi të vazhdueshëm, tejkalohen të gjitha vështirësitë.
- Para disa vitesh kam pasur një nxënës me hiperaktivitet, i cili as nuk donte të angazhohej dhe as të bashkëpunonte me shokët, ai kishte edhe probleme familjare gjë për të cilën e kemi pasur goxha të vështirë, unë si menaxhere e klasës dhe arsimtarët e tjerë.
- Ndikon edhe mos përgatitja e një nxënësi tek nxënësit e tjerë.
- Patjetër që ndikon, gjithnjë shembujt e mirë dhe nxënësit e dalluar i nxisin dhe motivojnë të tjerët, për të mësuar dhe edhe për t'i marrë shembull të sjelljes.
- Aty ku ka bashkëpunim dhe interesim të prindërve reflekton tek nxënësit në përmirësimin e tyre qoftë të vijueshmërisë, mësimeve, sjelljeve etj.
- Sjellja jo e mirë e nxënësve në klasë ndikon tek menaxhimi, sepse shpesh herë ndodh që plan-programi të mos realizohet sikur që është i paraparë për shkak të problemeve që menaxherit të klasës duhet t'i ndërmarrë, duke bërë kështu që të lë pak anash edhe nxënësit e tjerë, për t'i dhënë përparësi çështjeve problematike që paraqiten.

Rezultatet e pyetësorit të nxënësve:

Këtij pyetësori u janë përgjigjur **tetëdhjetë (80)** nxënës nga klasat 6-9.

Suksesi i tyre:

Mjaftueshëm	0 nxënës
Mirë	6 nxënës
Shumë mirë	28 nxënës
Shkëlqyeshëm	46 nxënës.

Si do të duket pjesa e konkluzionit. Për përgjigje kryesore do të përdoret grafiku si më poshtë:

1. Klasën e menaxhon kryetarja e klasës?

Po 66 nxënës.

Jo 14 nxënës.

2. Klasën e menaxhon kujdestari i klasës?

Po 72 n nxënës.


Jo 8 nxënës.




Në këtë pyetje të anketuarit janë pajtuar se kryetarja e klasës ndikon **aspak** vetëm dy(2), **pak** nëntë (9), **mesatarisht** pesëdhjetë e gjashtë (56), dhe **shumë** vetëm shtatë (7).




Kujdestarja e klasës ndikon më tepër nga sa mund të ndikoj një i përzgjedhur i nxënësve, të anketuarit janë pajtuar me këtë qëndrim, **aspak** dy (2), **pak** pese (5), **mesatarisht** tridhjetë e gjashtë (36) dhe **shumë** tridhjetë e shtatë (37).




Pajtueshmëria e nxënësve, është si në vijim **aspak**, një (1), **pak** tetëmbëdhjetë (18), **mesatarisht** tridhjetë e katër (34) dhe njëzet e shtatë (27) **shumë**.




Nga tetëdhjetë (80) të anketuar, të gjithë janë informuar se shkolla ka rregullore.




Këshilli i nxënësve ka marrë pjesë në hartimin e rregullores së shkollës, të anketuarit janë pajtuar me: **po** janë shprehur dyzetë e shtatë (47), **jo** dhjetë (10), dhe **ndoshta** njëzet e dy (22), ndërsa **s'ka rëndësi** vetëm një (1).




Lidhur me pyetjen e 8. Nxënësit kanë njohuri se seancat, diskutimet mbahen: **shpesh** njëzet e një (21) nxënës, **ndonjëherë** tridhjetë e nëntë (39) nxënës, **rrallë** shtatëmbëdhjetë (17), dhe **asnjëherë** tre (3) nxënës.




Nxënësit janë pajtuar se këto diskutime dhe reflektime i shfrytëzojnë **shumë** pesëmbëdhjetë (15) nxënës, **mesatarisht** dyzetë e dy (42), **pak** shtatëmbëdhjetë (17) dhe **aspak** gjashtë (6) nxënës.




Në këtë pyetje nxënësit janë shprehur se nuk kanë marrë vërejtje **asnjëherë** tridhjetë (30) nxënës, **rrallë** kanë marrë vërejtje njëzet e katër (24), **nganjëherë** njëzet e një (21) dhe **shpesh** pesë (5) nxënës.




Shkeljet të rregullorës së shkollës nga mësimdhënësi janë bërë **shpesh** pesë (5) herë, **nganjëherë** pesë (5) herë, **rrallë** shtatëmbëdhjetë herë (17), dhe **asnjëherë** pesëdhjetë e tre (53).




Nxënësit mendojnë se sjellja e tyre ndikon në procesin mësimor kanë zgjedhur; **shpesh** tridhjetë e një (31) nxënës, **nganjëherë** tetëmbëdhjetë (18) nxënës, **rrallë** njëzet e një (21), dhe **asnjëherë** dhjetë (10) nxënës.




Këshilla nga kujdestarja e klasës **marrin** gjashtëdhjetë e tre (63) nxënës, **nuk marrin** gjashtë (6) nxënës, **ndoshta** tetë (8), dhe **s'kanë rëndësi** këshillat tre (3) nxënës.




Këshillimi nga shoqëria qëndron në këtë proporcion. **Po** kanë zgjedhur njëzet e dy (22) të anketuar, **jo** shtatëmbëdhjetë (17), **ndoshta** tridhjetë e pesë (35) dhe **s'ka rëndësi** gjashtë (6), të anketuar.




Dënimet e prindërve janë të pranishme ndaj sjelljes së keqe të tyre: **shpesh** tridhjetë e tre (33), **nganjëherë** (26), **rrallë** gjashtëmbëdhjetë (16), dhe **asnjëherë** pesë (5).



Dënimet e mësimdhënësve janë të pranishme: **shpesh** kane zgjedhur tridhjetë e tri (33) të anketuar, **nganjëherë** njëzet e pesë (25), **rrallë** tetë (8), dhe **asnjëherë** katërmëdhjetë (14) të anketuar.




80 të anketuar nxënës, kanë zgjedhur se injorohen **shpesh** nga shoqëria dymbëdhjetë (12) nxënës, **nganjëherë** nëntëmbëdhjetë (19), **rrallë** njëzet e shtatë (27), dhe **asnjëherë** njëzet e dy (22) nxënës.




Mësimitdhënësit i shpërblejnë nxënësit me sjellje të mira: **shpesh** dyzetë e dy (42), **nganjëherë** njëzet e tre (23), **rrallë** gjashtë (6), dhe **asnjëherë** nëntë (9).


20. Situatat konfliktuale, në mes të nxënësve, arsimtarëve dhe të tjerëve në ambientet të shkollore mendon që mund të zgjedhen vetëm me:




Shumica e të anketuarve pajtohen se situatat konfliktuale duhet të zgjidhen me: **dialog**, shtatëdhjetë e një herë (71), **ndëshkim** pesë (5) herë, **forcë** një (1), **dhunë** tre (3).

Të shohim dhe përqindjen e kësaj pyetje në grafik.







Loja si pjesë e mësim, përdoret **shpesh** katërbëdhjetë (14) nxënës, **nganjëherë** tridhjetë e tetë (38), **rrallë** gjashtëmbëdhjetë (16), dhe **asnjëherë** dymbëdhjetë (12) nxënës.



Motivimi ndikon shumë janë përgjigjur për **po** pesëdhjetë e një (52) nxënës, **jo** vetëm tre(3), **ndoshta** janë përgjigjur njëzet e katër (24) dhe **s'ka rëndësi** dy (2), nxënës.



Bashkëpunimi në grupe **i nxit** pesëdhjetë e tetë (58) nxënës, **nuk i nxit** një(1), **ndoshta** i nxit janë shprehur nëntëmbëdhjetë (19) nxënës, dhe **s'ka rëndësi** vetëm dy (2), nxënës.



Në pyetjen e 24. 80 nxënës janë shprehur se: bashkëpunimi në grupe **i nxit** gjashtë (6) prej tyre për sjellje të këqija, **nuk i nxit** gjashtëdhjetë e tetë (68), **ndoshta** i nxit katër (4) dhe **s'ka rëndësi** vetëm dy (2) nxënës.

25. Çka do të ndryshonit ju në Rregulloren e shkollës?

Nga përgjigjet e nxënësve veçojmë:

- Nuk do të lejoja të përjashtohem nga shkolla
- Nuk do të ndryshoja asgjë.
- Rregullorja e shkollës është mjaft e mirë e përpiluar, prandaj nuk do të ndryshoja asgjë.
- Është shumë e mirë por ndonjëherë nuk përfillen rregullat nga nxënësit.
- Asgjë nuk do të ndryshoja, vetëm respektimi me të madh të rregullores.
- Do të ndryshojamënyrat e reja të ndëshkimit të nxënësve.
- Largimin nga shkolla e problematikëve dhe atyre të pasjellshëm, do t'i dërgoja në një shkollë tjetër.
- Do doja që ambienti i shkollës të mirëmbahet më shumë dhe me Rregullore të caktoheshin masat ndëshkuese për ata që nuk e respektojnë.
- Të mos mbahen telefona të mençur në shkollë.
- Pushimin e gjatë ta kalojmë jashtë dyerve të shkollës,
- Mos të hyjnë në këndin e leximit me këpucë nga oborri.
- Në lëndën e ed. fizike do t'i largoja disa arsimitarë.
- Të mos ketë dhunë ndaj nxënësve
- Nxënësit të vishen me uniformë dhe të respektojnë kodin e veshjes.
- Rregullorja është e mirë dhe nuk duhet të ndryshohet.
- Të përmirësojmë fjalorin, të sillemi mirë me të tjerët, të mos hedhim mbeturina në dysheme etj.
- Të kemi të drejtë të përdorim telefona të mençur në shkollë gjatë pushimit të gjatë.
- Mësimdhënësit t'i zbatojnë rregullat e tyre, të vijnë me kohë dhe t'i përmbahen temave.
- Asgjë nuk do të ndryshoja vetëm përmirësimin e kushteve.
- Të ketë tolerancë më të madhe, mos të përdoret dhuna e nxënësve ndaj njërit-tjetrit.
- Gjithçka në rregull.

26. Sa ndikon sjellja e juaj në shkollë?

Nga përgjigjet e nxënësve këto veçojmë:

- Ndikon shumë ngase nëse një vajzë sillet mirë, ajo merr privilegje nga mësimdhënësit.
- Sjellja ka për qëllim mirëqenien sociale, integrimin dhe jo diskriminimin dhe paragjykimin prandaj sjellja ime ka influencë në shkollë.
- Ndikon shumë
- Ndikon sepse duhet të bëjë sjellje të mira që edhe suksesi im të jetë i mirë.
- Sjellja është komponentë primare në shollën tonë.
- Ndikon sepse sjellja është pasqyrë e personalitetit.
- Ndikon pozitivisht.
- Mendoj se ndikon pozitivisht sepse mësimdhënësit na duan dhe na respektojnë më tepër.
- Tek shkolla ime sjellja është mbi të gjitha.
- Shumë sepse në një shkollë ku ka sjellje të këqija nuk regjistrohen nxënësit dhe humbet numri i shkollës.
- Unë mendoj se ndikon sepse fjalori duhet të jetë i pastër
- Ndikon si pozitivisht ashtu edhe negativisht.
- Deri në një masë ka influencë sepse sjellja e keqe ndëshkohet, ndërsa sjellja e mirë vlerësohet.
- Nëse të gjithë sillemi mirë atëherë nuk kemi rrëmujë në klasë, i gjithë procesi mësimor do të përfundojë me sukses.
- Sjellja jonë tregon kulturën dhe edukatën, nëse unë sillem mirë, shokët dhe shoqet e klasës do kenë dëshirë të rrinë me mua dhe do të mbështesin më shumë.
- Sjellja ndikon edhe tek notimi.

-Unë marrë lëvdata për sjelljen time dhe prindërit e mi janë krenarë kur dëgjojnë mësimdhënësit duke më lavdëruar.

-Shumë pak ka rëndësi, e rëndësishme është që unë të mësoj!

-Ndikon rreth 40 % të nxënësve.

27. A ndikon sjellja juaj në menaxhimin e klasës? A mund të cekni një rast të tillë?

Këto janë disa nga përgjigjet e të anketuarve:

-Ndikon ngase unë, kur dikush bën zhurmë, mësimdhënësi nuk shpjegon mësimet.

-Ka ndodhur një rast kur nxënësi është notuar me notën më të ulët vetëm për shkak se gjatë tërë vitit mësimorë ka qenë i zhurmshëm dhe pse në fund i është përgjigjur të gjitha pyetjeve, ai është vlerësuar më pak për shkak të sjelljes së tij.

-Unë mendoj se sjellja e ndonjërit individ reflektohet në menaxhimin e klasës.

-Kur mësimdhënësja e klasës mungon disa ditë, për menaxhimin e klasës janë përkujdesur disa mësimdhënës të tjerë, mirëpo këta mësimdhënës nuk kanë pasur informata rreth karaktereve, personalitetit, sjelljeve tona dhe mënyrës së të mësuarit, kanë krijuar paragjykim dhe na kanë vlerësuar më ulët ngase at ditë ne kishim testim verbal.

-Kur ka sjellje të mira në klasë është më lehtë të menaxhohet, p.sh nxënësit e din se ku duhet të ulen dhe që duhet të mirëmbajnë ambientin të mos lënë mbeturina afër bankave etj.

-Në një ambient të qetë e të përshtatshëm i gjithë procesi mësimorë zhvillohet pa problem.

-Deri më tani më ka ndodhur që një herë të bëjë probleme në klasë dhe kujdestarja e klasës sime, ka ftuar për takim prindërit e mi, prej atëherë unë nuk kam bërë me probleme.

-Kujdestarja e klasës më merr shembull mua për sjelljen time të mirë, prandaj edhe shoqet e mija kanë dëshirë të rrinë me mua.

-Unë kam qenë në grupin menaxhues të klasës dhe të gjithë më dëgjojnë dhe sillen mirë me mua.

-Ndikon sidomos në aspektin e ndëshkimeve dhe masave që merren ndaj nxënësit që shkakton probleme.

Kapitulli i katërt

Analizë sociologjike

Aktualiteti në të cilin jetojmë tani, brenda procesit të edukimit arsimit në Kosovë shpesh shfaq një shthurje nga procesi i zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike. Ne dallojmë nga vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian jo vetëm për mundësitë e zhvillimit të një mësimi në një dhomë me teknologji e mundësi didaktike të shekullit XXI, por edhe për mënyrën e qasjes së problemeve dhe mungesës së stafi shtesë për mësimdhënës shtesë, psikologë, pedagogë, pavarësisht faktit se edukimi është pjesë e pa ndarë e shoqërisë dhe pjesëmarrës kyç janë nxënësit, të cilët arrijnë të përvetësojnë njohuritë dhe vlerat që na përcjellin gjatë gjithë jetës.

Gjithsesi, një grup shoqëror nuk mund t'i japë kurrsesi të gjitha njohuritë apo vlerat në të cilat mund të identifikohen si shoqëri përparimtare, sepse edukimi nuk fillon vetëm me procesin e shkollimit, por në të rol kyç luan edhe familja, shkolla, shoqëria-moshatarët, interneti e faktorët tjerë të vazhdueshëm. Edhe *sjellja* bën pjesë në edukimin qytetar.

Pjesëmarrës të veprimtarisë në procesin mësimor (*udhëheqjen e shkollës, mësimdhënësit, nxënësit*) duhet që me angazhim të plotë t'u përmbahen rregullave apo kodeve shkollore, që nga respektimi i uniformës shkollore e deri tek rregullat e klasës, që janë të përcaktuara nga shkolla.

Sepse kodi synon të rregullojë raportet mes mësuesve dhe nxënësve, të cilat kanë qëllim të largimit të nxënësve nga dukuritë negative shoqërore, siç janë narkotizmi, alkooli, prostitucioni, trafikimi etj.

Sa herë përmendim kodin na bënë të mendojmë për sjelljen dhe në raport kolektiv të nxënësve, e cila nuk duhet të shkaktojë shqetësime tek prindërit, nxënësit, mësimdhënësit e tjerë, sepse edukata qytetare është lëndë e qytetarisë që i bën

nxënësit të përgatitën për jetën me njohuritë e domosdoshme praktike për ligjin dhe me aftësinë për t'i përdorur ato në jetën e përditshme.

Lënda e edukatës qytetare natyrisht që ndikon dhe mund të ndihmojë në *menaxhimin e orës mësimore*, duke shpjeguar ne si mësimdhënës me fjalë të thjeshta arsyet se pse është i rëndësishëm arsimimi në jetën e një individi, çka përmban rregullorja e shkollës, cilat janë dënimet për ata që pengojnë procesin mësimor, çka janë normat, të drejtat dhe përgjegjësitë, vendimmarrja dhe institucionet, çka nënkuptojmë me mjedisin, resurset dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Po ashtu, edukata qytetare rrit nivelin e ndërgjegjësimit dhe të njohurive për çështjet dhe kundërshtitë e sotme lidhur me ligjin dhe zbatimin e fushave kryesore të veprimtarisë njerëzore; rrit dalëngadalë pjesëmarrjen aktivet qytetare në fushën e respektimit të Kushtetutës dhe të drejtave të njeriut; zhvillon ndjenjën e tolerancës, të paanshmërisë dhe të drejtësisë; zhvillon vullnetin dhe aftësinë për të zgjidhur mosmarrëveshje përmes rrugës apo mekanizmave zyrtare të të menduarit kritik dhe arsyetimin e komunikimit. Komunikimi jo korrekt, jo vetëm që i demotivon nxënësit për punën e tyre mësimore, por pengon gjithë procesin mësimor, duke çuar në disa raste edhe në dështimin e plotë të tij, që lidhet drejtpërdrejtë në *menaxhimin e orës mësimore*.

Ndërveprimi pozitiv mësues-nxënës, dhe komunikimi korrekt aftërsia dhe respekti reciprok vendosin tonet e një marrëdhënie pozitive brenda dhe jashtë klasës.

Sjellja korrekte joverbale e mësuesit ndikon në shumë drejtime:

1. Në krijimin e një ambienti mbështetës dhe inkurajues gjatë orës së mësimin, nëpërmjet përdorimit të përcjelljes së autoritetit dhe krijimit të sigurisë për nxënësin;

2.Në krijimin e marrëdhënieve pozitive mësues nxënës, nëpërmjet demonstrimit të ngrohtësisë vërtetësisë, respektit dhe empatisë (Kostelnik: 2010). Monitorimi i rregullimi dhe kontrolli i komunikimit joverbal influencon rrjedhën dhe përfundimin e ndërveprimit njerëzor dhe kontribuon në efektivitetin intrapersonal (Riggio,2006).

Konkluzione

Si ndikon menaxhimi i klasën tek sjelljet e nxënësve, duke ditur se të gjithë fëmijët janë të ndryshëm nga njëri tjetri dhe mësojnë në mënyra të ndryshme, shkolla do të mbetet sistem i krijuar nga shoqëria për interesat e vetë shoqërisë dhe asnjëherë nuk duhet ta humb kuptimin edukativo-arsimor dhe rregullimin e sjelljes qytetare.

Komunikimi transparent, konkret dhe i plotë është çelës për të krijuar këtë partneritet me të gjitha organet e nevojshme, të cilat janë në interes të shkollës dhe të bashkësisë së gjerë. Në mënyrë që komunikimi të realizohet me sukses, gjithsesi duhet paraprakisht të përgatitet plani për komunikimin, në të cilin duhet të merren parasysh shumë aspekte, si: formati i komunikimit, personat me të cilët duhet komunikuar, përzgjedhja e strategjive më të përshtatshme për komunikim, afatet kohore dhe subjektet e ngarkuara për komunikim etj.

Praktika të ndryshme të menaxhimit të sjelljeve të nxënësit në shkollë duhet të jenë strategji të afta për të trajtuar problemet gjatë zhvillimit të procesit edukativo-arsimor, sepse në klasë paraqiten probleme të llojllojshme dhe të natyrave të ndryshme por më së shpeshti hasim kur mësimdhënësit punojnë në klasë me nxënësit e moshave të ndryshme, veçanërisht faza e adoleshencës që është një përballje më ndryshe, gjatë kësaj kohe duhet të ruhet klima pozitive në mësim dhe të ndihmohen nxënësit që të prezantojnë një sjellje të pëlqyeshme në mjedisin e klasës ku ata kalojnë një pjesë të madhe të angazhimit aktiv të kohës së tyre.

Nga vetë hulumtimi dhe anketimi i realizuar kemi kuptuar se menaxhimi i klasës ndikon shumë tek të gjithë, pra ndikon në organizimin e procesit mësimor, në mbarëvajtjen, në atmosferën e duhur mësimore, në motivimin, nxitjen (cytjen) si dhe gjithçka tjetër që do të jetë më lehtë e përballueshme. Nga anketimi i

mësimdhënësve kuptojmë që jo vetë përgatitja e duhur dhe kualifikimi janë të mjaftueshme ngase në praktikë ka shumë raste ku nevoja është edhe më e tepërt. Bashëkpunimi me kolegët, fryma e mirë kolegjale, dhe shkëmbimi i përvojave janë mëse të nevojshme që të realizohet puna me sukses.

Nga anketimi i nxënësve del se dialogu dhe diskutimet/ reлектimet janë diçka që ata preferojnë ngase duket sikur afërsia dhe thyerja e një muri fiktiv mes tyre dhe mësimdhënësve është diçka e vështirë për t'u arritur. Gjithashtu shpërblimi për sjelljet e mira është diçka që ata i nxit për të punuar më shumë dhe për t'iu përkushtuar punës më me zell.

Nga këto të dhëna që kemi, sjellim disa rekomandime të domosdoshme.

Rekomandimet

Komunikimi transparent, konkret dhe i plotë është çelës për të krijuar këtë partneritet me të gjitha organet e nevojshme, të cilat janë në interes të shkollës dhe të bashkësisë së gjerë. Në mënyrë që komunikimi të realizohet me sukses, gjithsesi duhet paraprakisht të përgatitet plani për komunikimin, në të cilin duhet të merren parasysh shumë aspekte, si: formati i komunikimit, personat me të cilët duhet komunikuar, përzgjedhja e strategjive më të përshtatshme për komunikim, afatet kohore dhe subjektet e ngarkuara për komunikim.

Përgatitja e duhur dhe në nivel e më shumë strategjive menaxhuese të sjelljes së nxënësit nga ana e mësimit është një veprim i suksesshëm, sepse i mundëson atij që, kur strategjia e parë nuk funksionon, të përdorë formën e dytë që të jetë e suksesshme në administrimin e klasës. Në arsim fjala menaxhim ka kuptimin që një mësimit të administrojë, të drejtojë, organizojë punën mësimore si dhe procesin mësimor në klasën e tij/saj, duke respektuar ligjet, udhëzimet administrative, rregullat e shkollës si dhe rregullat e klasës. Trajtimi teorik mbi menaxhimin e klasës dhe reflektimin rreth metodologjisë efektive për zbatimin praktik nën klasë, janë dispozitat themelore me të cilat realizohet mësimdhënia e suksesshme.

Menaxhimi i klasës brenda një viti shkollor ka të bëjë me drejtimin e klasës, formimin e grupeve, fillimin dhe përfundimin e mësimit, ekologjinë e klasave, klimën e klasës, motivimin e nxënësve, vetitë e mësimit, komunikimin me nxënës etj.

Një formë e organizimit të klasës ka të bëjë edhe me organizimin e projekteve e iniciativave tjera jashtë kurrikulare me nxënës, si: vizita pune jashtë shkollës,

mësime jashtë shkollës (dhomës së mësimit), projekte të ndryshme individuale dhe grupore, prezantime me tema të ndryshme sepse menaxhimi i klasës është praktika dhe procedura që lejojnë.

Rëndësi të veçantë gjatë menaxhimit të klasës ka edhe raporti mësues-nxënës, e cili duhet të krijohet me një kujdes të veçantë, duke ruajtur distancën emocionale, por njëkohësisht duke u interesuar për pasionet e nxënësve, me përgatitje duke ndërtuar besim dhe duke komanduar sepse, nëse ne nuk e drejtojmë klasën si liderë, atëherë këtë pozicion ka gjasa ta përfitojë dikush nga nxënësit. Mësuesi ideal përdor teknika të ndryshme në mësim, ka një sens humori, i mban premtimet, ka dëshirë t'i dëgjojë të dy palët gjatë një problemi, përdor një ton të këndshëm, është miqësor, komunikim i hapur duke përdorur më shumë dialogun sesa monologun.

Mësimdhënësi duhet vazhdimisht të mbajë shënime për suksesin, angazhimin dhe ngecjet e nxënësve në lëndë të ndryshme dhe brenda lëndëve në kapituj të ndryshëm. Kjo për qëllimin e vetëm që të ndihmojë që gjatë planifikimit dhe përgatitjes për të organizuar orën mësimore apo mësimin gjatë ditës të mos hasim në situata të pakëndshme e herë-herë të na dështojë krejt ora.

Roli i prindit përfshin padyshim më shumë se një vijimësi të veprimeve të veçanta, cilësitë dhe karakteristikat e tij si person do të kenë një mbështetje të rëndësishme në performancën e tij si prind.

Interesimi i nxënësve për mësim duhet të ketë një komunikim të qëndrueshëm, konstruktiv dhe të rregullt, nëradhë të parë në mes të vetë organeve të shkollës, e pastaj edhe mes faktorëve të tjerë, në këtë kontekst një komunikim i efektshëm mes mësimdhënësve dhe nxënësve është parësor dhe thelbësor, duke vazhduar edhe me prindërit e nxënësve, sepse koncepti i një shkolle demokratike dhe bashkëkohore kërkon vënien e të drejtave të fëmijëve në qendër të shkollës.

Të gjithë autorët nga literatura dhe referencat e shfrytëzuara pajtohen që menaxhimi i klasës sipas standardeve pedagogjike është i lidhur ngushtë me çështjen e motivimit, disiplinës dhe respektit, sepse metodologjitë mbeten çështjen e debatit të pasionuar midis mësuesve, sepse një pjesë më madhe e menaxhimit tradicional ka në lidhje me psikologjinë arsimore, praktika të mira ndikojnë në krijimin e klimës pozitive në klasë.

ANEKS

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS:

**Universiteti i Evropës Juglindore
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Drejtimi: Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim**



I/e dashur mësimdhës/e

Anketa aktuale synon të shqyrtojë ndikimin e menaxhimit të klasës në sjelljet e nxënësve. Ne jemi mirënjohës për kontributin tuaj në këtë studim që do të ndihmojë për të analizuar këtë tezë. Plotësimi i këtij pyetëso do t'ju marrë vetëm 10-15 minuta të kohës tuaj. Do t'u ishim shumë falënderues nëse do ta plotësonit. Natyrisht, pjesëmarrja juaj është plotësisht vullnetare. Ju mund të ndërprisni intervistën në çdo kohë. Të dhënat e mbledhura do të përdorën vetëm për analizën statistikore, e cila bëhet në mënyrë anonime. Ne do të kujdesemi që të ruajmë anonimitetin tuaj duke mos zbuluar dhe raportuar askund emrin tuaj. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Emri: _____

Mbiemri: _____

Data: _____

Ju lutem shënoni përgjigjen tuaj duke vendosur **X** në katrorin përkatës:

1. Unë e di kuptimin e menaxhimit të klasës.

1 Po 2 Jo

2. Menaxhimi i klasës ndikon në procesin mësimor.

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

3. Sa ndikon pozitivisht monitorimi i përformacës në orët tuaja, në aspektin e menaxhimit të klasës?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

4. Sa bashkëpunoni me kolegët tjerë?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

5. Sa mendoni që kanë ndikim mësimdhënësit e tjerë në menaxhimin e klasës?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

6. A mbani seanca diskutimi, aftësimi dhe reflektimi për zbatimin e rregullores së shkollës?

1 Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

7. A i shfrytëzoni këto diskutime/reflektime për planifikimin e zhvillimit tuaj profesional ?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

8. A keni marrë pjesë në orën e ndonjërit kolegë nga aktivi juaj (sa shpesh)?

1 Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

9. A ka pasur rast që ndonjëri prej kolegëve tuaj të kërkoj ndihmë për menaxhimin e klasës?

1 Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

10. A ka pasur rast kur keni kërkuar ndihmë për menaxhimin e klasës?

1. Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

11. Marrë infomata nga Drejtori i shkollës për më të rejat-teknikat, rregulloret e reja për menaxhimin e klasës

1. Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

12. Për menaxhimin e klasës, mësimdhënësi duhet të ketë zhvillim profesional të caktuar, për lëndën përkatëse.

1. Po 2 Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

13. Për menaxhimin e klasës, mësimdhënësi duhet të përdor strategji dhe praktika të ndryshme në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

1. Po 2 Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

13. Për menaxhimin e klasës, mësuesi duhet të ketë raporte të mira me drejtorin e shkollës.

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

15. Për menaxhimin e klasës, mësuesi duhet të ketë raporte të mira me pedagogun.

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

16. Për menaxhimin e klasës, mësuesi duhet të ketë raporte të mira me prindër.

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

17. Për menaxhimin e klasës, mësuesi duhet të respektoj të drejtat e njeriut, krijimin e mjedisit të punës.

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

18. Menaxhimi i klasës përfshinë gjithçka që bën mësuesi për të organizuar nxënësit, kohën, materialet në mënyrë që nxënësit të nxënë.

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

19.Mësimdhënësi duhet vazhdimisht të mbajë shënime për suksesin, angazhimin dhe ngeçjet

e nxënësve në lëndë të ndryshme dhe brenda periudhave të ndryshme.

1. Po Jo ₃ Ndoshta ₄ S'ka rëndësi

20.Mësimdhënësi duhet vazhdimisht të mbajë shënime për ndryshimin e sjelljes tek nxënësi.

1. Po Jo ₃ Ndoshta ₄ S'ka rëndësi

21.Mësimdhënësi duhet të mbajë shënime për vërejtjet që i shqipton gjatë procesit mësimor.

1. Po Jo ₃ Ndoshta ₄ S'ka rëndësi

22.Për të pasur sukses procesi mësimor duhet të përfilllet rregullorja e shkollës për sjelljet e nxënësve dhe mësimdhënësve.

1. Po Jo ₃ Ndoshta ₄ S'ka rëndësi

23.Çka do të ndryshonit ju në rregulloren e shkollës?

24.Cilat janë disa nga sekretet e punës suaj për menaxhimin sa më cilësor të klasës (si kujdestar klasë) dhe si mësimdhënës?

25. A ndikon sjellja e nxënësve në menaxhimin e klasës? A mund të na cekni një rast të tillë?

Faleminderit!

PYETËSOR PËR NXËNËS

Universiteti i Evropës Juglindore
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Drejtimi: Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim



I/E dashur nxënës/e

Anketa aktuale synon të shqyrtoje ndikimin e menaxhimit të klasës në sjelljet e nxënësve. Ne jemi mirënjohës për kontributin tuaj në këtë studim që do të ndihmojë për të analizuar këtë tezë. Plotësimi i këtij pyetësi do t'ju marrë vetëm 10-15 minuta të kohës tuaj. Do t'iu ishim shumë falënderues nëse do ta plotësonit. Natyrisht, pjesëmarrja juaj është plotësisht vullnetare. Ju mund të ndërprisni intervistën në çdo kohë. Të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për analizën statistikore, e cila bëhet në mënyrë anonime. Ne do të kujdesemi që të ruajmë anonimitetin tuaj duke mos zbuluar dhe raportuar askund emrin tuaj. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Emri: _____
Data: _____

Mbiemri: _____

Ju lutem shënoni përgjigjen tuaj duke vendosur **X** në katrorin përkatës:

Kjo anketë nuk është test e as provim. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara. Nëse nuk gjeni përgjigjen që përshtatet plotësisht, shënoni atë që është më e përafërt. Ju lutemi, shënoni përgjigjen tuaj duke përorurshenjën “X” në kutinë përkatëse, ose duke plotësuar hapsirën e zbrazët. Administruesit e pyetësorit do ju ndihmojnë në çdo rast.

Faleminderit që merrni pjese! Ju lutemi filloni.

Ju lutem të shënoni klasë jeni aktualisht:

1 Klasa 6

2 Klasa 7

3 Klasa 8

4 Klasa 9

Ju lutem shënoni suksesin tuaj

1 mjaft.

2 mirë

3 shumë mirë

4 shkëlq.

Pyetësori për mësimdhënësin

Ju lutem të tregoni se në çfarë niveli gjërat e mëposhtme aktualisht janë në shkollën tuaj. Për secilën nga përgjigjet tuaja, përdoreni shkallën në vazhdim:

1= Aspak, 2= Pak, 3= Mesatarisht, 4= Shumë, si dhe forma tjera (1 = Po, 2 = Jo, 1 = Asnjëherë, 2 = Rrallë 3 = Nganjëherë, 4 = Shpesh).

1.Klasën e menaxhon kryetarja e klasës

1 Po 2 Jo

2.Klasën e menaxhon kujdestari i klasës

1 Po 2 Jo

3. Sa ia del kryetarja e klasës të ndikojë tek sjelljet e nxënësve të tjerë?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

4.Sa ja del kujdestarja e klasës të ndikoj tek sjelljet e nxënësve të tjerë?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

5. A ka kohë mësimdhënësi/ja juaj të shqyrtojë çdo problem në klasë.

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

6. A ka shkolla juaj rregullore të shkollës.

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka

rëndës

7. Këshilli i nxënësve a ka marrë pjesë në hartimin e rregullores së shkollës?

1. Po Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

8.A mbani seanca diskutimi, aftësimi dhe reflektimi për zbatimin e rregullores së shkollës?

Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëher 4 Shpesh

9.A i shfrytëzoni këto diskutime/reflektime tek nxënësit e tjerë?

1 Aspak 2 Pak 3 Mesatarisht 4 Shumë

10.A keni marrë ndonjëherë vërejtje për sjellje brenda procesit mësimor?

1 Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

11.Mësimdhënësi juaj a bënë shkelje të rregullores së shkollës?

2 Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

14.A ndikon sjellja juaj në procesin mësimor?

1. Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

15.Për sjelljen time këshillohem me prindërit e mi.

1. Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

16.Për sjelljen time marrëkëshilla nga kujdestarja e klasës .

1. Po 2 Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

15..Për sjelljen time marrë këshilla nga shokët/shoqet.

1. Po 2 Jo 3 Ndoshta 4 S'ka rëndësi

16. Kur unë sillem keq me prindër, ata më japin dënime.

1. Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

17. Kur unë sillem keq me mësimdhënësin, ata më japin dënime.

1. Asnjëherë 2 Rrallë 3 Nganjëherë 4 Shpesh

18. Kur unë sillem keq me shokët/shoqet, ata më injorojnë.

1. Asnjëherë 2. Rrallë 3. Nganjëherë 4. Shpesh

19. A ju shpërblejnë mësimdhënësit për sjellje të mira?

1. Asnjëherë 2. Rrallë 3. Nganjëherë 4. Shpesh

20. Situatat konfliktuale në mes të nxënësve, arsimtarëve dhe të tjerëve në ambientet të shkollore mendon që mund të zgjedhen vetëm me :

1. dhunë 2. forcë 3. ndëshkim 4. dialog

21. A përdoret ndonjëherë lojë për motivimin e juaj ?

1. Asnjëherë 2. Rrallë 3. Nganjëherë 4. Shpesh

22. A ndikon motivimi i mësimdhënësit në sjelljen tuaj?

1. Po 2. Jo 3. Ndoshta 4. S'ka rëndësi

23. Bashkëpunimi në grupe a ju nxitë juve për sjellje më të mira?

1. Po 2. Jo 3. Ndoshta 4. S'ka rëndësi

24. Bashkëpunimi në grupe a ju nxitë juve për sjellje më të këqija?

1. Po 2. Jo 3. Ndoshta 4. S'ka rëndësi

23. Çka do të ndryshonit ju në rregulloren e shkollës?

24.Sa ndikon sjellja në shkollën tuaj?

25.A ndikon sjellja juaj në menaxhimin e klasës? A mund të na cekni një rast të tillë?

Momente gjatë plotësimit të pyetësorit:

Nxënësit e shkollës fillore “Eqrem Çabej”, ”Bedri Gjinaj”, Mitrovicë



Referencat

Alma Muharremi, Menaxhimi i mësimi

Abdal-Haqq, I. (1998). Constructivism in teacher education: Considerations for those who would link practice to theory. (ED426986). Washington DC: ERIC Digest.

Abrahamson, L. A. Teaching with Classroom Communication System - What it Involves and Why it Works ** Better Education Inc., 4824 G. Wash. Mem. Hwy., Yorktown, VA 23692, USA Agbuga, B. (2011). Expectancy-Value Model of Achievement Choice and Self-Reported Disruptive Behaviors of Elementary School Students, Education and Science 2011, Vol. 36, No 160.

Armendariz, F., & Umbreit, J. (1999). Using active responding to reduce disruptive behavior in a general education classroom. Journal of Positive Behavioral Interventions, 1, 152-158.

Barker, L. L. (1982). Communication in the Classroom. Prentice Hall Inc. Englewood Cliffs.

Becher, R. (1993). "The Aesthetic Classroom Environment and Student Attitude Toward School". Dissertation Abstracts International. Vol.53. No.9. p. 37-41.

Brophy, J. & Good, T. (1986). Teacher Behavior and Student Achievement. In M. Wittrock (Ed.) Handbook of Research on Teaching (3rd ed). Macm.

Brophy, J. (1988). "Educating Teachers About Managing Classroom and Students". Teaching and Teacher Education. Vol 4. No 1.(pp.1-18).

Brooks, J. G. M. G. Brooks (1999). In Search of Understanding The Case for Constructivist Classrooms. Alexandria, VA, USA. Association for Supervision & Curriculum Development. <http://site.ebrary.com/lib/akdeniz/Doc>.

Certo, S. C. (2000). Modern Management. (8th Ed.) Prentice-Hall Inc. New Jersey.

Charles, C.M. (2005). Building Classroom Discipline. Collaboration by Gail Senter. Emeritus San Diego state university. Eight edition.

Cummings, C. (2001). *Strategies for Classroom Management*. Teaching, inc. Virginia, USA.

Doyle, E. (1986). "Classroom Organisation and Management". *Handbook of Research on Teaching*. Ed. Merlin C. Wittrock, Third Ed. Macmillan Pub. Comp. New York.

Dreikurs, R. (1968). *Psychology in the Classroom*. New York: Harper and Row. (2nd Edition).

Eccles, J. & Others. (1991). "What Are we Doing to Early Adolescents? The Impact of Educational Context on Early Adolescents". *American Journal of Education*. Vol. 99. No.4. p. 521-539.

Edwards, C. H. (2000). *Classroom Discipline and Management*. 3rd. Ed. John Wiley & Sons, Inc.

Gable, R., & Manning, M. (1996). Facing the challenge of aggressive behaviors in young adolescents. *Middle School Journal*, 27(3), p. 19-24.

Gable, R. A., Quinn, M. M., Rutherford, R. B., Jr., & Howell, K. E. (1998). Functional behavioral assessments and positive behavioral interventions. *Preventing School Failure*, 42, p. 106 - 119.

Gelfand, D.M. & Hartmann, D.P. (1975). *Child behaviour: analysis and therapy*. New York: Pergamon Press. George, C. L. (2010). Effects of response cards on performance and participation in social studies for middle school students with emotional and behavioral disorders. *Behavioral Disorders*, 35, p. 214-228.

Grubaugh, S. & Huston R. (1990). "Establishing a Classroom Environment That Promotes

Harris, A. H. (1991). "proactive classroom Management: Several Ounces of Prevention". *Contemporary Education*. Vol.62. No.3.(pp. 156-160).

Hull, J. (1990). *Classroom Skills. A Teacher Guide*. David Fulton Pub. London.

Jacobsen, D. & Others. (1985). *Methods for Teaching. A Skills Approach*. Second Ed. Charles and Merrill Pub. Comp. Columbus.

Reed, D. (1989). Student teacher problems with classroom discipline: Implication for program

Rregullore –Për sjellje dhe disiplinë të nxënësve për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Mitrovicës

Rregullore –Për sjellje dhe disiplinë të nxënësve në sh.f.m.u”Eqrem Çabej”

Rich, J. M. (1991). “Should Student Be Pushed?”. Contemporary Education. Vol. 62.

Rickman, L. & Hollowell, J. (1981): some causes of student teacher failure. Improving college and university Teaching. Vol.29. No. 4.(pp. 176-179).

Musai, B. (1999). Psikologji edukimi (zhvillimi, të nxënët, mësimdhënia), Shtëpia botuese dhe shtypshkronja PEGI, Tiranë.

Musai, B. (2003). Metodologji e mësimdhënies, PEGI, Tiranë.

Musai, B. (2005). Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues: modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve: cikli fillor, CDE, PEGI, Tiranë.

Verial, D., Types of Classroom Interaction eHow Contributor | updated January 26, 2011
Volenski, L. T. & Rockwood, P. (1996). Family Environment and School Behavioral Problems [microform]/Leonard T. Volenski and Paul Rockwood Distributed by ERIC Clearinghouse,[S.l.]

Yang, K. M., & George, S. (1995). The effects of Self – Evaluation, Self – Observation, and Self – Observation plus Self – Recording on the Occurrence of Disruptive Behaviors in Classroom: Extension Study, ED 385 028.

Zajazi, T. (2003). Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies (Didaktika). Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “Vinsent Graphic”, Shkup.

Wlodkowski, R. J. (1982). Discipline: The great false hope. Unpublished manuscript, University of Wisconsin- Milwaukee. (Eric Document Reproduction Service No. ED 224 782.).